



Parlamenti i I-re Rural Shqiptar

Më vjen mirë që si Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë kontaktin e parë me shoqërinë civile e realizoj në kuadër të nismës së Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural për ngritjen dhe funksionimin e Parlamentit Rural shqiptar. Njëkohësisht pranova me kënaqësi ftesën për të asociuar autoritetin e Kryetarit të Kuvendit me Parlamentin Rural Shqiptar, nismë kjo që do të përsëritet në mënyrë periodike çdo dy vjet. Prania sot e një përfaqësie kaq të gjerë aktorësh të ndryshëm nga i gjithë vendi, iniciativa juaj për të bashkuar zërin dhe përpjekjet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së jetës dhe politika më mbështetëse dhe inkurajuese për një zhvillim të qëndrueshëm lidhet më së miri edhe me objektivat e punës sonë në Kuvend.

Kam mësuar nga diskutimet tuaja gjatë dy ditëve të fundit për të krijuar një sinergji midis aktorëve të qeverisjes vendore dhe të biznesit e shoqërisë civile. Kjo na inkurajon edhe më shumë për të bërë gjithçka të mundur në mbështetje të përpjekjeve tuaja. Inkurajoj edhe “Grupin Miqtë e Parlamentit Rural” (ku bëjnë pjesë deputetë dhe ish-Ministra të Bujqësisë) të ndjekin me vëmendje dhe të mbështesin në vazhdimësi Rrjetin Kombëtar për Zhvillimin Rural si mekanizmi që do të zbatojë objektivat e punës suaj sipas edhe Deklaratës që keni miratuar dhe do e bëni me dije sot.

Nga ana tjetër, kabineti im do të mbajë kontakte të vazhdueshme me Rrjetin Rural. Por, më vjen mirë të them se prioritetet e punës suaj përkojnë me programin e qeverisë së re, dhe Komisioni Parlamentar i Veprimtarisë Prodhuese i cili ndodhet i ftuar në këtë aktivitet besoj se do ta ketë në axhendën e punës së tij një vlerësim të vazhdueshëm për ecurinë e objektivave tuaja.

Mu duk interesante edhe idea juaj e decentralizimit të parlamentit rural, që do të thotë, që në bazë të katër rajoneve të vendit të krijoni parlamentet rurale rajonale si forume diskutimesh, bashkërendimesh, dhe partneriteti midis aktorëve publik, agjencive rajonale, qarqeve, bashkive me biznesin rural dhe shoqërinë civile. Mendoj se kjo do të krijojë një dinamikë të re duke nxitur bashkëpunimet për zhvillim sipas prioriteteve të territoreve të ndryshme të vendit për zhvillimin ekonomik dhe social.

Inkurajoj njëherazi dhe Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe Korçës, shkollat profesionale, agjencitë e ndryshme kombëtare dhe të huaja që ndihmojnë vendin tonë të bëhen pjesë e kësaj nisme për t'i ardhur në ndihmë zhvillimit, punësimit, zhvillimit tërësor të territoreve sipas përvojave të vendeve Europiane.

Përfitoj nga rasti të ftoj Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe qarqet akademike të bëhen më shumë kontributor duke i ofruar ekspertizë profesionale vendimmarrjes parlamentare, po kështu edhe Komisionet në Kuvend duhet t'i kushtojnë hapësirën dhe kohën e nevojshme mendimit të specialistëve dhe studiuesve.